

**DREJTORIA E RAJONIT JUGOR GJIROKASTER**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

*Data 08.11.2018*

Për: „**RIVIERA**„ *shpk*, *adresa: Rruga „Themistokli Germenji“ , Nr. 3/2, Tirane.*

Procedura e prokurimit: Procedure e hapur, sherbime

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF – 73988 – 06 – 07 - 2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës : **“Mirembajtje Rutine e Dimerore me Performance rruga Permet – Carshove – Tre Urat (Dogane) + rruga Carshove – Leskovik - Erseke + rruga Leskovik – Tre Urat (Dogane) 107 km”**, per nje periudhe 2-vjecare.

Fondi limit : 58 565 552 leke pa TVSH.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike data 11.06.2018 nr. 23.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Riviera” shpk. NIPT J66903244D  
*Vlera 42 553 700 (dyzet e dy miljon e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind) leke pa tvsh*
2. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Artyka II” shpk & “Avdolli” shpk  
NIPT-K 26625603U NIPT : K14721001P

Vlera : 42 988 640 (*dyzet e dy milion e nenteqind e tetedhjetë e tete mijë e gjashteqind e dyzet*) leke pa tvsh

4. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Du & Ko” shpk & “Alb Konstruksion” shpk

NIPT K38207309W NIPT J76705049N

Vlera : 51 659 200 (*pesedhjetë e një milion e gjasheqind e pesedhjetë e nente e dyqind*) leke pa tvsh.

5. Operatori Ekonomik “2 T” shpk NIPT K01731001M

Vlera : 52 709 000 (*pesedhjetë e dy milion e shtateqind e nente mijë*) leke pa tvsh.

6. Operatori Ekonomik “Gjikuria” shpk NIPT J62903456H

Vlera : 53 295 960 (*pesedhjetë e tre milion e dyqind e nentëdhjetë e pese mijë e nenteqind e gjashtedhjetë*) leke pa tvsh.

7. Operatori Ekonomik “Alb Korca 2002” shpk. NIPT K34004003T

Vlera 53 689 300 (*pesedhjetë e tre milion e gjashteqind e tetedhjetë e nente mijë e treqind*) leke pa tvsh.

8. “Adem Pojani” sh.p.k (Nuk ka paraqitur oferte e dokumentacion te plote)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Du & Ko” shpk & “Alb Konstruksion” shpk
2. Operatori Ekonomik “Alb Korca 2002” shpk.

Përkatësisht për arsye të mëposhtme:

**Bashkimi i Operatoreve ekonomik Du & Ko shpk & Alb Konstruksion shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit si më poshtë:**

Operatori ekonomik Alb Konstruksion shpk, pjesë e këtij bashkimi, sipas kontratës së bashkëpunimit ka marrë persiper të kryej 80% të shërbimeve. Në kundërshtim me pikën 2.3.12 të dokumenteve të tenderit ku përcaktohet se *”Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik...çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, në përputhje dhe përputhje me punët e marrë për sipas marrëveshjes së bashkëpunimit”*, ky operator nuk disponon kategorinë përkatëse në licencën profesionale NP – 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Operatori ekonomik Du & Ko shpk, pjesë e këtij bashkimi nuk plotëson kriterin 2.3.1 të dhënë në dokumentet e tenderit ku thuhet *”Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme mirëmbajtjeje rutine e dimerore rrugësh në një vlerë jo më pak se 40% e fondit limit që prokurohet dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit”*, në raport me përcaktimin e dhënë në pikën 2.3.12. *”Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, në përputhje dhe përputhje me punët e marrë për sipas marrëveshjes së bashkëpunimit. Kontrata e paraqitur me nuk është e ngjashme me ” mirëmbajtjeje rutine e dimerore rrugësh”*.

Në vërtetimin e paraqitur që konfirmon shlyerjen e pagesave të energjisë elektrike, rezulton që Operatori ekonomik Alb Konstruksion shpk, në kundërshtim me pikën 1/d të kriterëve të veçanta për kualifikim nuk ka shlyer detyrimet të maturuara të energjisë elektrike të muajit maj 2018. (Mbi

detyrimet e maturuara sipas Vendimit te ERE-s, Nr.109, date 21.10.2011, “Per miratimin e kontratës se furnizimit me energji elektrike te klientëve jofamiljare, neni 9/1, *Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*”)

**Operatori ekonomik Alb Korca 2002, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:**

Per kapacitetin teknik “Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi”, operatori ekonomik Alb Korca 2002 shpk ka paraqitur kontraten e furnizimit nga subjekti “Duro shpk”, date 21.06.2018. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Gjikuria shpk”, rezulton qe subjekti “Duro shpk”, date 11.07.2018, i ka nenshkruar ketij te fundit nje kontrate qeraje per kete kapacitet, me afat 3 vjecar cfare verteton faktin qe kontrata e furnizimit eshte e pavlefshme.

Formularët E-SIG, rezultojne te jene te pakonfirmuara nga organet perkatese me nenshkrime elektronik ose ne hard copy, ne kundërshtim me piken 2.3.2, te kriterëve te dhene ne DST.

Nuk ka permbushur sic duhet piken 2.2.3, te kerkesave per kualifikim, pasi nuk ka paraqitur dokument qe vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ne Korce dhe Erseke ku ka ushtruar aktivitetet per vitin 2017.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, „**RIVIERA**„ shpk, adresa: Rruga „Themistokli Gërmenji“, Nr. 3/2, Tirane.se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 42 553 700 (dyzet e dy milion e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorise se Rajonit Jugor Gjirokaster, ish-Zona Industriale Gjirokaster nr. tel. 084262529 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.08.2018

Ankesa: Ka patur ankese nga Bashkimi i operatoreve ekonomike “Du & Ko” shpk & “Alb Konstruktion” shpk dhe Bashkimi i operatoreve ekonomike “Artyka II” shpk & “Avdolli” shpk. Kane marre pergjigje ne daten 10.08.2018 dhe 13.08.2018. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Du & Ko” shpk & “Alb Konstruktion” shpk ka bere ankese ne KPP. Me vendimin nr. 714/2018 date 23.10.2018 KPP ka refuzuar ankesen.